Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës Jugore
Opština Južna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South

02-060/01-0055100-5/26
24.09.2026

KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT
Nr. 02-060/01-0055100-5/26 dt.24.09.2026
Mitrovicë

Bazuar në nenet 12, dhe 14, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (GZ Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008); nenin 26, të Rregullores së (QRK) nr. 09/2020, për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, në nenin 13, paragrafi 1, nën paragrafi 1.4 dhe 15 të Statutit të Komunës; në zbatim të Memorandumit për bashkëpunim ndërmjet Ministrisë së sportit dhe rinisë dhe Komunës së Mitrovicës së Jugut Nr. 01-0400/01-0023557/26 të dt. 28.04.2026 Për mbështetje financiare dhe bashkëpunim institucional për realizimin e projekteve infrastrukturore sportive në Komunën e Mitrovicës, si dhe duke marrë parasysh faktin se pjesa e propozuar e parcelës së identifikuar për realizimin e projektit infrastrukturor sportiv është në harmoni me dokumentin ne fuqi përkatësisht Hartën zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut (HZK), shkresën e Ministrisë së mjedisit dhe planifikimit hapësinor Nr.3953/26 të dt. 29.07.2026, me rekomandim të Komitetit për Politikë dhe Financa (Konkluzioni Nr. 02-060/01-0053079-3/26 dt. 15.09.2026) Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me 24.09.2026 sjell këtë:

VENDIM
Për caktimin të pronës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit

1. MIRATOHET Vendimi për caktimin të pronës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit.
2. Qëllimi i miratimit të këtij Vendimi për caktimin e parcelës është realizimi i marrëveshjes ndërmjet Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Ministrisë së Sportit dhe Rinisë, me të cilën do të ndërtohen fusha e tenisit dhe fusha e padelit, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi.
3. Lokacioni i caktuar sipas pikës 1 të këtij Vendimi është sipërfaqja prej 10000 m^2, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 39283 m^2 të Parcelës Kadastrale Nr. P-71208032-00399-5, e cila gjendet në vendin e quajtur "Përzhina-Lumi Ibër", Zona Kadastrale Zhabar i Epërm, pronë e Komunës së Mitrovicës së Jugut.
4. Parcela katastrale nga pika 3 e këtij vendimi është në harmoni të plotë me dokumentin e planifikimit në fuqi, përkatësisht me Hartën Zonale të Komunës së Mitrovicës së Jugut, zonë rekreative turistike - ZRT-2, (fushë futbolli/poligon sportiv).
5. Ndarja e parcelës nga pika 2 e këtij Vendimi të evidentohet në Regjistrin e të drejtave pronësore.
6. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria e Pronës, Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër dhe Drejtoria për Planifikim dhe Urbanizëm.
7. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet Vendimi Nr. 02-060/01-0035074-4/26 dt. 29.06.2026 Për destinimin të pronës komunale për ndërtimin e fushave të tenisit dhe të fushave të padelit.
8. Vendimi shpallet tridhjetë (30) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale dhe hyn në fuqi shtatë (7) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb faqen e Komunës së Mitrovicës së Jugut.

Mitrovicë

Kryesuesi i Kuvendit
Safet KAMBERI

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E MITROVICËS MITROVICE-MITROVICA OPŠTINA MITROVICA REPUBLIKA KOSOVO

Dorëzohet:
1 x 1 **Kryesuesit të Kuvendit**
1 x 1 **MAPL-së**
1 x 1 **Arkivit**
Kopje: **Kryetarit të Komunës**
Drejtorisë së Pronës
Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër
Drejtorisë për Planifikim dhe Urbanizëm dhe
Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport